

## LIBRI "ARTI I REAGIMIT" DHE PERBALLJA IME ME POLITIKANET E INTELLEKTUALET

Suplementi i së dielës te SHQIPTARJA.com

E-mail: rilindasi@gmail.com

# RILINDASI

Viti II - Nr:42

E diel, 28 tetor 2012

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni  
edhe  
online

www.shqiptarja.com

## THIRRJA E AGIM VINCES Shqipëria të kujdeset për shqiptarët jashtë kufirit

Jolanda Lila

Në një kohë kur apatia dhe mosreagimi ndaj padrejtë sive e problemeve shoqërore ka përpirë të gjithë shqiptarët, pavarësisht nivelit shoqëror që përfaqësojnë: përballë këtij realiteti, ku të gjithë ulin kokën dhe pranojnë në heshtje e kapërdijnë çdo prapësi të keqeverisjes dhe sharlatanizmit të politikanëve apo drejtuesve, thajse në të gjitha nivelet drejtuese, pikërisht mes kësaj amulie mbizotëruese dhe njëherësh paralizë të reagimit, vjen një zë kumbues, një penë e ndritur, një autoritet i mendimit dhe i shkencës shqiptare, një personalitet imponues dhe gjithnjë kërkues e hetues i së vërtetës, vjen profesori i nderuar Agim Vinca me librin e tij "Arti i reagimit".

Ashtu siç shenjohej që në titull, kjo përmbledhje shkrimesh publicistike përçon art, si në aspektin



Në foto:  
Shkrimtari  
Agim  
Vinca dhe  
libri i tij  
"arti i  
reagimit"

formal ashtu edhe në atë përmbajtësor. Publicistika e profesor Agim Vincs karakterizohet nga gjuha e gjallë dhe leksiku i pasur, që gërshetohet me mjeshtërinë e letrarit, i cili me finesë, vërtetësi e qartësi sjell copëzat dhe fragmentet e jetës së mishëruar në të. Kjo cilësi e një mjeshtri të fjalës, bën që shkalla e ndikimit të shkrimeve dhe të temave të rrokura prej realitetit historik dhe aktual të jetë shumë e madhe të receptuesit. Natyrshmëria dhe qartësia e stilit të publicistikës së profesor Agim Vincs janë një sistem reference për të gjithë, por në mënyrë të veçantë ky libër shërben si një manual shumë i mirë orientimi për mënyrën se si mund të shkruajmë dhe të shprehemi mbi fenomene të ndryshme, që shqetësojnë realitetin tonë.

Për t'u ballafaquar me problemet e realitetit kërkohet guxim, larpamësi e mençuri dhe pikërisht këto... **vijon në faqen 14-15**

### Speciale Arbëreshët/ Faleminderit, atë Camodeca!

Pietro Abitante

Mbrojtja dhe ruajtja e një minorance etniko-linguistike vjen sidomos nga afërsia e kufinjve me gjuhën "pritëse", siç është psh. italishtja për gjer-

manishten e altoatezinëve dhe për frengjishten e valdostanëve. Por kur flitet për ishuj gjuhësorë, si ato shqiptare në Itali, nuk është e njëjta gjë. Roli kryesor në mbrojtjen e identitetit tonë e ka pasur feja: dihet që tradita dhe

feja me ritualitetin e saj janë një binom historik i pa ndarë. Një shembull i qartë është figura e një prifti të shekullit XIX, Pietro Camodeca de' Coronei nga Castroregio, qendër e vogël e Kalabrisë. është falë... **faqe 19**

### "Ejani sot, o Shqipëtarë...", strofa e pabotuar e Asdrenit

Është një strofë e cilë nuk gjindet as në Reze Dielli (1904), as në Ëndra e Lotë (1912), as në Psallme Murgu (1930). Poeti s'e ka botuar gjër më sot në asnjë vënd, ajo gjindet midis letrave në bibliotekën e tij në Bukuresht

Nga Lasgush Poradeci

Mbledhja e parë që pr ofessori Kiriak bëri për formimin e Korit shqiptar ish në Sala Transilvania, më 1907. Aty i-a-u ndau pjesëtarëve të rinj shqiptarë zërrat sipas cilësisë përkatëse: sopran, tenor, bas, etj. - i parë më të parë, i dytë më të dytë etj. - dhe tashi, në një pushim plot gas dhe kënaqësi artistike, plot hov patriotik, ay i thotë Asdrenit i cili ndodhej midis këngëtorëve dhe ish i dëgjuar nga emri si vjershëtor kombëtar pas shqiptjes së vëllimit të tij Reze Dielli në Bukuresht më 1904: Ti je poet, bëj një strofë shqip që t'a harmonizoj për korin dhe t'a kën-

dojmë. Pa mbaruar dhe fare këto fjalë mjeshtri i math, gjithë anëtarët e korit buçitën me një zë në mes të entuziaszmës: rroftë Asdreni! rroftë Asdreni!, Asdren! Asdren!, marshin Asdren!, marshin shqip! marshin shqiptar!. Dhe si të rinj që ishin dhe kokën plot tym me Shqipëri që e kishin, kush prej tyre këndonte një varg të himnit rumun, kush një motiv ushtarak, kush prapë dhe gjë e çuditshme po fare e vetëshpëguar... një frazë muzikore të romancës së zemrës së tij. Pastaj u mblodhë në thirrjen e bilbilkës...

Pa u turbulluar aspak prej zhurmës së shokëve të tij të korit në ushtërim e sipër solfegjesh, siç ish... **faqe 18**



### Mbrëterësha Geraldinë '38-'39, jeta në Shqipëri përmes 10 fotove

Me anë të këtij reportazhi fotografik, përkujtojmë sot 10 vjetorin e vdekjes së mbretëreshës së shqiptarëve, Geraldinë, të ndarë nga jeta në Tiranë, më 22 tetor 2002

### Hebrejtë, falsifikimi i dokumenteve shtetërore dhe fetare në Kosovë

Etërit katolikë në Shkup dhe Ferizaj ishin kthyer në mbrojtës të devotshëm të refugjatëve të huaj - kryesisht hebrej. Madje ata punonin në mënyrë sistematike, duke ofruar strehim, dokumente pagëzimi...

Agron Alibali

Sot pranohet përgjithësisht se hebrejtë që u zhvendosën në Shqipëri gjatë Luftës II Botërore janë shpëtuar që të gjithë, ndërsa në Kosovë disa prej tyre nuk e patën këtë fat. Edhe propaganda e qarqeve serbe nuk ka munguar të nxijë realitetin historik që lidhet me këto ngjarje. Mirëpo në këtë drejtim ka një neglizhim të paspjegueshëm edhe tek të tjerë. Kësisoj, edhe libri i shumëpërmendur "Besa" me foto të shqiptarëve që kanë shpëtuar hebrej gjatë Luftës, me autor Norman Gershman, një pjesë të mirë të personazheve të tij i ka nga Kosova, por kjo pak theksohet në përmb-

bajtje apo në ekspozimet e shumta nëpër botë të këtyre fotove të rëndësishme. Dokumenti amerikan i përcjellë edhe në Pjesën II zbulon një përmasë të re të kontributit të popullit të Kosovës në shpëtimin e hebrejve të ish-Jugosllavisë që u detyruan të gjejnë strehim atje.

Letrat e Identitetit

Sikurse u përmend në Pjesën I, Letra e Identitetit ishte një prej dokumenteve të lëshuara në Shqipëri dhe të përdorura nga hebrejtë për të fshehur identitetin e tyre të vërtetë dhe për t'i shpëtuar kësijoi valës naziste. Raporti ynë përmend se Letra e Identitetit përdorej edhe nga hebrejtë... **faqe 20**

## RRËFIMI | I POETIT

# AGIM VINCA:

## Shteti shqiptar të kujdeset për shqiptarët jashtë kufijve

Jolanda Lila

vijen nga faqja 13

...cilësi shpërfaq autori, teksa ekspozon një bosht tematik, që rrok çështje të ndryshme, si: situata politike e shoqërore, opinione për çështje të rëndësishme kombëtare, përshkrimi i veprimtarisë jetësore e profesionale të heronjve dhe personalitetëve me kontribut intelektual, letrar e patriotik, krijimi i UÇK-së dhe fakte tronditëse të luftës së Kosovës e deri tek përsiatjet e thella dhe refleksimet rreth botës.

Agim Vinca kritikon dhe nxjerr në pah jo vetëm të keqen që vjen nga jashtë, konkretisht nga pushtuesit, por edhe atë që vjen nga brenda, si pasojë e anarkisë, hipokrizisë, servilizmit, frymës së shkatërrimit etj.

"Arti i reagimit" është libri i tretë publicistik i autorit, që vjen pas librave "Populli i pandalur" (1992) dhe "Shqiptarët mes mitit dhe realitetit" (1997), si një vokacion i pastër dhe i hapur për çështje të jetës së përditshme dhe për çështjen kombëtare në tërësi.

Për të mësuar më shumë rreth përmbajtjes së këtij libri, ju ftojmë të lexoni një intervistë që autori ka dhënë për Radio Kontaktin, ku ai rrëfen arsyet që nxorën në dritë këtë libër publicistik.

**Pse "Arti i reagimit"? Çfarë keni dashur të shenjoni me këtë titull?**

Titujt e librave janë si emrat e fëmijëve, autorët gjithnjë kanë dilema si t'i pagëzojnë ata. Unë kam menduar gjatë për titullin e këtij libri dhe kam ardhur në përfundim se ky titull, pra "Arti i reagimit", i përshtatet përmbajtjes së tij. Shumë nga shkrimet e librit janë reagime të lindura në çaste dhe situata të ndryshme historike, nëpër të cilat kanë kaluar shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, madje dhe të Shqipërisë, në këto 10-12 vitet e fundit. Dihet që kjo është periudhë e ngjarjeve dramatike, si: rënia e komunizmit, robëria e Kosovës, rezistenca paqësore, lufta e armatosur, bombardimet e NATO-s, çlirimi i Kosovës, vendosja e administratës së UNMIK-ut pas luftës, një lloj protektorati ndërkombëtar në bashkëqeverisje me vendorët, që zgjati deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008; zhvillimet pas shpalljes së pavarësisë etj.

Koncepti i këtij libri mbështetet në reagimin intelektual ndaj ngjarjeve, dukurive dhe situatave nëpër të cilat kanë kaluar shqiptarët gjatë kësaj periudhe.

**Ajo çfarë të bën përshtypje është fakti që dhe pse ka kaluar një periudhë kohore, duke ditur që disa nga shkrimet tuaja datojnë nga vitet 1998-99, sërisht kur i lexon ato arrin ta kuptosh sfondin. Ka një lloj ekstrakti që nuk është fort i zakonshëm për publicistikën, e jo më kot gazetarët njihen si shkruarës të sotmes dhe historianët si shkruarës të së djeshmes. Ndërkohë që ju i keni alternuar magjishëm këto dy kohë. Cili është çelësi për ta arritur këtë?**

Këto nuk janë shkrime të një gaze-



Në foto: Shkrimtari Agim Vinca

tari, por të një krijuesi e intelektualit, i cili vokacion të vetin e ka letërsinë, kurse profesion studimin e letërsisë dhe mbajtjen e leksioneve në fakultet. Këto shkrime kanë lindur si rezultat i shtytjeve të mia intelektuale. Intelektuali nuk mund të jetë indiferent ndaj zhvillimeve të kohës. Sociologë e filozofë të shquar kanë shfaqur mendime për këtë çështje. Kështu, fjala vjen, sociologu dhe filozofi bashkëkohor francez, Edgar Moren, thotë se intelektual nuk është njeriu që merret me çështje të profesionit të tij (shkrimtari, filozofi, mjeku, avokati etj.), por njeriu që angazhohet me problemet e kohës së vet dhe se, rrjedhimisht, jo çdo njeri i shkolluar mund të quhet intelektual, duke shtuar se misioni i tillë i intelektualit bëhet i nevojshëm sidomos në kohë krizash, kur shoqërisë i kanoset rreziku i

Titujt e librave janë si emrat e fëmijëve, autorët gjithnjë kanë dilema si t'i pagëzojnë ata. Unë kam menduar gjatë për titullin e këtij libri dhe kam ardhur në përfundim se ky titull, pra "Arti i reagimit", i përshtatet përmbajtjes së tij

erozionit moral, në mos edhe ndonjë katastrofë. Duke dashur ta arsyetojë këtë mendim të tij, Moreni thotë se Zola ishte shkrimtari i njohur, madje edhe themeluesi i një shkolle letrare - natyralizmit, edhe para vitit 1898, por intelektual u bë kur shkroi pamfletin "Jaçuse" (Akuzoj), me të cilin mori në mbrojtje kapitenin Drapfus, të burgosur padrejtësisht mbi bazën e një akuzë të rreme.

Ka edhe shumë shembuj të tjerë, nga Sokrati e gjer te Unamuno, por nuk dëshiroj të zgjatem me numërimin e tyre. Dëshiroj të them se edhe unë, me mundësitë e mia, i frymëzuar nga shembujt e ndritshëm, të cilët nuk mungojnë as në letërsinë dhe kulturën shqiptare (Noli, Konica etj.), kam bërë përpjekje ta marr në mbrojtje popullin tim prej sulmeve, akuzave, shpifjeve, denigri-

meve dhe në përgjithësi nga fushata antishqiptare, që zhvillohej në vitet '90, sikurse edhe më parë, nga propaganda serbe.

Shkrimet e këtij libri mbajnë qëndrim kritik ndaj fenomeneve negative në shoqëri dhe posaçërisht ndaj faktorëve që janë bartës dhe frymëzues të tyre. E këto janë në radhë të parë formacionet politike e shtetërore dhe njerëzit që janë në krye të tyre. Jam përpjekur gjithmonë të shpreh mendimin tim kritik me kohë ndaj problemeve shoqërore e politike, edhe atëherë kur ato mbështeten nga një numër i madh njerëzish, për të mos thënë nga shumica dërrmuese. Nuk jam pajtuar me të ashtuquajturën "lëvizje paqësore, pacifiste" në Kosovë, e cila ishte pozitive në fillim, kur doli në skenë, në fillim të viteve '90, por pastaj u akomodua në "pushtet" dhe u bë si të thuash një lloj legjitimimi i dhunës dhe terrorit të përditshëm milloshëvician në Kosovë. Konsideroja se duhej një lëvizje më aktive, mosbindje qytetare, protesta, demonstrata, greva, në mos edhe diç më shumë: kryengritje e armatosur. Kam qenë ndër mbështetësit e protestës së njohur të 1 tetorit 1997 të studentëve dhe mësimdhënësve të Universitetit të Prishtinës, por edhe dhe organizator i saj në nivel të Fakultetit të Filologjisë dhe të Degës së Letërsisë Shqipe, protestë kjo që kundërshtoi nga kryesia e LDK-së, përfshirë edhe disa kolegë të mi profesorë, që ishin anëtarë të saj ose të afërt me të. (Dihet se kujt i dha koha të drejtë). Kam mbështetur pa rezervë, ndër të parët nga intelektualët kosovarë, daljen në skenë të UÇK-së; i jam kundërvënë propagandës kundër saj me gojë dhe me shkrim, në intervista në mediat e shkruara e elektronike, me shkrime e fjalë të mbajtura në tribuna të ndryshme, brenda e jashtë, çfarë është, fjala vjen, tribuna e rëndësishme me temë: "Dopo la Bosnia, il Kosovo" (Pas Bosnjës, Kosova), e mbajtur në Romë në tetor 1998, në organizim të Fondacionit "Moravia", ku unë u paraqita me kumtesën "Holokausti kosovar, thirrje ndërjegjës së Evropës", e cila u botua në revistën e njohur "Quadrerni" të Romës (nr. 1.99), nën titullin "Kosovo, olocausto di fine secolo".

**Domethënë ju jeni angazhuar përveçse me shkrime edhe me veprimtarinë tuaj të drejtpërdrejtë intelektuale?**



REPORTAZH | FOTOGRAFIK



“Kur më ftuan në Oborin mbretëror shqiptar, pasi mbreti kishte parë disa foto të miat, familja kërkoi në emrin tim që gjithëkë të mbahej sekrete dhe që t'i lihej një muaj kohë për të reflektuar. Kohë më pas, im shoq, me një buzëqeshje të lehtë, më rrëfeu një të fshehtë : ”  
Më erdhi mirë nga kjo kërkesë që vinte nga një zemër e fortë dhe jo nga një kokë boshe, dhe që nuk shfaqte asnjë lloj ambicije personale ”.

**Në foto:** Kontesha Geraldine Appony, zonjushë nderi në martesën e motrës së saj Virxhinia, në Pallatin e kontëve Karoli, në Budapest (Hungari), më 1937. Ishte një nga tre fotot që këshilltarët hungarezë në Oborin shqiptar i paraqitën mbretit Zog, kur ky kërkoi të bashkëshorte.



**Në foto:** Durrës, janar 1938. Geraldina pret motrën e saj që vjen të marrë pjesë në ceremonitë e fejesës. Nga e majta në të djathtë : Sali Doshishti (nip i mbretit Zog), çambelani Sotir Martini, André de Baghy (kunati i Geraldinës), Geraldina dhe motra e saj Virxhinia, baronesha Rüling (damë shoqëruese austriake), Hysen Doshishti (nip i mbretit) dhe një oficer i Gardës mbretërore.

“Përpara se t'i gjykojmë shqiptonjat, duhet bujtur në folenë e tyre ”

Një reportazh fotografik me dhjetë pamje të mbretëreshës Geraldinë në periudhën e saj shqiptare, në vitet 1938-1939. Secila nga fotot është pajisur me një shënim të vetë mbretëreshës, të botuara në biografinë e saj zyrtare, me autore Joséphine Dedet. Me anë të këtij reportazhi fotografik, përkujtojmë sot 10 vjetorin e vdekjes së mbretëreshës së shqiptarëve, Geraldinë, të ndarë nga jeta në Tiranë, më 22 tetor 2002.

Materiali është mbledhur nga Niko Kotherja, përkthyer nga frëngjishtja prej Thomas Frashërit, me autorizimin e autorit Joséphine Dedet.

# MBRETERESHA

## Jeta në Shqipëri

Me anë të këtij reportazhi fotografik, përkujtojmë sot 10 vjetorin e vdekjes së mbretëreshës së shqiptarëve, Geraldinë, të ndarë nga jeta në Tiranë, më 22 tetor 2002



“ Veç ëndërroja dhe përpiqesha të kuptoja, përgatitesha të isha e denjë për çka po me priste ”.

“Mbreti më puthi dorën dhe më sugjeroi një kolltuk të cilin s'e kisha vënë re sepse ndodhej nën një kamare. Atje, të mbrojtur nga vështrimet, mundëm më në fund të flisnim lirisht. Cdo fjalim ceremonial ishte i kotë, ndaj mbreti më kërkoi menjëherë nëse pranoja të bëhesha grua e tij. Nuk isha e mësuar të flisja me një burrë 20 vjet më të madh se unë, por në atë çast çdo ndjenjë frike u shpërbë. Ju përgjigja çka më urdhëronte zemra dhe vetëm kaq. Sapo ishim njohur, por e kisha të pamundur t'i rezistoj sharmit që përmbante gjithë gënia e tij : ndihesha vërtet e dashuruar. Pa dashur të analizoja atë çka ndjeja, e kisha të qartë se nuk kisha takuar kurë më parë një burrë si ai. ”



E fejuar me mbretin Zog në Pallatin mbretëror të Tiranës, në janar 1938



Në foto: Në ditën e fejesës, 31 janar 1938



"Jam vajza më e lumtur në botë!!! Është një mrekulli të jesh parreshtur, në çdo çast, me atë që do dhe që aq shumë të do."



Në foto: Martesa mbretërore në Tiranë, më 27 prill 1938.



"Ministra, deputetë, përfaqësues bashkiakë të Tiranës... Të gjithë këto personalitete ishin ftuar të hynin në sallonin e Vilës Toptani, që shumë shpejt u mbush me qindra kurora lulesh. Nga jashtë dëgjoheshin duartrokitje dhe brohoritje të popullit. Dola në ballkon e mallëngjyer, bashkë me motrën time Virxhina, kur natin, baroneshën Ryling dhe gjeneral Seregjin, adjutant i mbretit. Në atë moment, kuptova madhësitinë e asaj që po ndodhte dhe se sa e denjë duhej të tregohesha për mikpritjen që më ishte rezervuar. Përhëndeta për herë të parë në mënyrën shqiptare: krahun e djathtë të mbështetur mbi gjoks, që nënkupton "Ju kam në zemrën time".



"Kisha përshtypjen që prita që mu bë në këtë vend ishte e singhtë. Midis Shqipërisë dhe atdheut tim, Hungarisë, nuk ka patur as luftërë, as mërira shekullore. Madje, kujtimet e lavdishme të besëlidhjes midis Skënderbeut dhe Huniadit veç na bashkonin."

# GERALDINE '38-'39


## përmes 10 fotove




"Kudo më prisnin me një ngrohtësi dhe zemërmirësi të patreguar, deri në shtëpitë më të thjeshta."

"Në orën 10, një ministër i moshuar më jepte mësim historie dhe gjuhë shqipe. Në mesditë, prisja në audiencë, njëri pas tjetrit, Kryeministrin, drejtorin e Kryqit të kuq dhe drejtorin e spitalëve, të cilët më informonin për çdo çështje që kishte të bënte me mbarëvajtjen e kushteve të grave."

Filloam të përpilonim projekte ambicioze: blerje klinikash ambulante, instalime qëndrash shëndetësore deri në fshatrat më të thellë. Dëshiroja gjithashtu të prisja, të paktën një herë në javë, delegacione grash dhe vajzash nga çdo rajon i Shqipërisë."



"E magjepsur nga bukuria e vendit, kisha parandjenjë që potencialet e mëdha turistike të tij do të ishin me një rëndësi kyçe në tërheqjen e kapitaleve dhe zhvillimin e Shqipërisë. Plazhet e mrekullueshme të rivierës shqiptare dhe rajonet e përshtatshme për sportet dimërore dëshmonin që mundësitë ekzistonin. Mbetej për tu instaluar infrastruktura e nevojshme, teleferikët, krijimi i pistave për ski. Mbreti zhavitej nga entuziazmi im dhe më thoshte se me të gjitha këto duhet të merresha unë, pasi në këto pesëmbëdhjetë vitet e fundit, atij mezi i dilte koha të ndërtonte një shtet!"



"Roli i një mbretëreshë: përbushje e një detyre dhe besinkëri ndaj një dashurie"

"Do të vdes si një shqiptare, në tokën shqiptare dhe mes shqiptarëve."

HIMNI | KOMBËTAR

# "EJANI SOT, O SHQIPETARE..."

## Strofa e pabotuar kurrë e Asdrenit

Është një strofë e cila nuk gjindet as në Reze Dielli (1904), as në Ëndra e Lotë (1912), as në Psallme Murgu (1930). Poeti s'e ka botuar gjer më sot në asnjë vënd, ajo gjindet midis letrave dhe shkresave të tija, në bibliotekën e tij në Bukuresht

Nga Lasgush Poradeci

**Paravajftja e himnit: Marshi atdhesor në dorëshkrim "ejani sot, o shqipëtarë"**

Mbledhja e parë që profesori Kiriaq bëri për formimin e Korit shqiptar ish në Sala Transilvania, më 1907. Aty i'a-u ndau pjesëtarëve të rinj shqiptarë zërrat sipas cilësisë përkatëse: sopran, tenor, bas, etj. - i parë me të parë, i dytë me të dytë etj. - dhe tashi, në një pushim plot gas dhe kënaqësi artistike, plot hov patriotik, ay i thotë Asdrenit i cili ndodhej midis këngëtorëve dhe ish i dëgjuar nga emri si vjershëtor kombëtar pas shtypjes së vëllimit të tij Reze Dielli në Bukuresht më 1904: Ti je poet, bëj një strofë shqip që t'a harmonizoj për korin dhe t'a këndojmë. Pa mbaruar dhe fare këto fjalë mjeshtri i math, gjithë anëtarët e korit buçitnë me një zë në mes të entuziazmës: rroftë Asdreni! rroftë Asdreni!, Asdren! Asdren!, marshin Asdren!, marshin shqip! marshin shqiptar!. Dhe si të rinj që ishin dhe kokën plot tym me Shqipëri që e kishin, kush prej tyre këndonte një varg të himnit rumun, kush një motiv ushtarak, kush prapë - dhe gjë e çuditshme po fare e vetëshpieguar... - një frazë muzikore të romancës së zemrës së tij. Pastaj u mblodhë në thirrjet e bilbilkës që i lajmëronte për ushtërimet, për ushtërimet e para, që të familiarizohen me notat dhe gamat dhe tonet e veçanta të psalmodive. I tërhiqte pa e kuptuar për këto natyra gazmore, zemra e ëmël prej artisti dhe personaliteti dinamiku, vulkanik i profesorit të adhuruar. Asdrenin, që aty një ças përpara e kishin qëndër të përfllakëve të tyre, tashi e kishin harruar... s'e vinin më re... Ay ish larguar aty pranë, rinte litar në një qoshe të sallës së madhe. Rinte i thjeshtë dhe mendonte i thjeshtë dhe punonte i thjeshtë një këngë Shqipërije të thjeshtë, siç ka qënë, siç i ka patur përherë hije zemrës së tij së thjeshtë prej njeriu dhe prej atdhetari dhe prej artisti të thjeshtë që ka qënë kurdoherë veterani poet Asdren. Kur me rastin e kremtimit kombëtar që organizoj Kollonija për Asdrenin në gjashtëdhjetvjetorin e tij në Bukuresht shkronjësi i këtyre radhëve u ftua për pjesëmarrje si ish-shtëpjak i familisë së saj së madhe, nuk mendoj mënyrë më të përshtatur përshëndetjeje së-largu nga një vënd i huaj ku kaloj nëntë vjet i etuar për Shqipëri, sesa mënyrën që ishte, natyrisht, mënyra dhe qenia e gjithënjëshme, ngjyra e pandryshuarshme e burrit, shqiptarit dhe vjershëtorit Asdren: Thjeshtësia; dhe i dërgoj lavdurimin e thjeshtë, që pat përbërë

vetë lavdinë e portretit të thjeshtë të jetës dhe të punës dhe të shkrimit të thjeshtë të Asdrenit:

Burr' i urtë-e i veçuar,  
Shqipëtar me shpirt të qruar,  
Vjershëtor vjershë-kënduar  
Pate shkruar e punuar,  
Kombin për t'a kombësuar,

Shqipen për t'a shqipëzuar.

Pa u turbulluar aspak prej zhurmës së shokëve të tij të korit në ushtërim e sipër solfegjesh, siç ish tërhequr Asdreni ashtu, improvizoj-atje, në Sallën Transilvania, atë çastrofën patriotike që fillon me vargun:

"Ejani sot, o Shqipëtarë..."

Është një strofë e cila nuk gjindet as në Reze Dielli (1904), as në Ëndra e Lotë (1912), as në Psallme Murgu (1930). Poeti s'e ka botuar gjer më sot në asnjë vënd, ajo gjindet midis letrave dhe shkresave të tija, në bibliotekën e tij në Bukuresht. Ka qënë poezi me rimë, poezi sepse Asdreni pat bërë katër strofa, nga të cilat profesori Kiriaq vuri në nota vetëm një, dyke i kënduar pastaj kori të tjerat pas së parës. Atë strofë të Asdrenit Kiriaq-u e bëri me zë që të kenë anëtarët e korit një marsh patriotik për të kënduar dhe ekzekutuar midis ndërpushimeve ose në çdo rast manifestimi.

Ç'ishin këta, cilën ishin këta anëtarë kaq idealistë të Korit shqiptar të Bukureshtit? Ishin të rinj thuasje që të gjithë, po të rinj me zemër burri, me kurajë prej luani. Ata u çquan dhe janë çquar gjithnjë, gjer në vdekje ose gjer tashi në moshtë të vjetëruar, me punën e tyre shqiptare të palodhur. Tridhjet veta të vendosur për ritjen e emrit të atdheut, midis të cilëve vëllezërit Dhimitër Zografi dhe Grigor Zografi, me tregëtoren e tyre fole të dëgjuar për punët mëmëdhatare, zotërinjtë Llambi Cicimiçi, Dhimitër Kalakuçi (Dhimitër Konea), Ilija Teodoru (Ilija Shupelka) dhe Pandel Durmishi, punëtori boem i palodhur, zemërbardhi që bënte përdita therrorinë shoqërore të krishtit për të afërmin shqiptar, anëtar për të cilin mosmarrja pjesë qoftë dhe vetëm një herë në mbledhjet e Kollonisë përbente një mallkim familjar - siç kish zakon të përsëriste ay vetë me gojën e tij



Asdreni

në raste përkatëse, Rafail Anastasiu (Rafail Anastas) dhe Andrea Alilozi, besniku me besë të pathyer i kryetarit të famshëm të Shoqërisë "Drita" për mësimin shqip Nikol N. Naço-Korça nga prindër prej qarkut të Pogradecit, tregëtar i math Grigor Goda, arkëtar i shoqërisë për një kohë të gjatë, i cili me rreptësinë e llogaritit dinte të pajtojë kurdoherë një liri të arësyeshme nisjative kur ish fjala e përkrahjes së një anëtarëve nevojtaro po të vlefshëm prej nderin e atdheut, Jani Danga prej Postënanit, psalt vetëdashës i parë i kishës shqipe bashkë me psaltin vetëdashës të dytë Zisi Andrea Stavre, nipin prej vëllaj të Asdrenit, Jani Danga Postënanit, që kish ëmbëltoe luksi ku bënte porositi e ëmbëlsirave dhe te konfiturave pallati mbretëror i Rumaniisë, u bë i vlershëm me të plotë për titullin e veteranit të Kollonisë aq nga shërbimi gjithnjë i gatëshëm ndaj çështjeve shoqërore, sa dhe

me udhëheqjen vepëronjëse të komunitetit orthodhoks si kryetar, përiudhë në të cilën u çqua në mënyrë të veçantë me mbledhjen e sumës prej katërqind e pesëdhjetmijë lei të Rumaniisë për rindërtimin, pikturimin dhe pajosjen me tërë aparat liturgjik dhe stolitë priftërore të kishës istorike dhe monumentore Më një ditë (Dint' o zi), e dyta falëtoare kombëtare e shqiptarëve të Bukureshtit: ishin dhe këngëtorët e tjerë të korit, me vlera të ndryshme, në gjith atë lartësi patriotike si të lartpërkruarit, dhe njëri prej tyre, për shëmbell, nxori thikën si vetëtim dhe goditi pa asnjë fjalë për vdekje një grek nga të kryeqytetit rumun, vetëm e vetëm nga shkak i thjeshtë se ky kuxoj t'i-a shajë Shqipërinë me rastin e një bashkëfjalimi në mes të rrugës...

Me kësi përbënjes të flaktë, përkundër punës së përditëshme me të cilën ishin zënë të gjithë siç u shënuar në radhët e mësipërme, kori

vijonte për të mbarë pa asnjë ndërkeputje, vijonte regullisht natën po dhe ditëve të Djela si dhe ndonjë të kreme rastore gjatë muajit. Vetëm një incident, incident i pamjenjanshëm sepse i zakonshëm, i zakonshëm sepse i nevojshëm, i nevojiturshëm, nga nevoja, çqetësonte veshin simfonik të Kiriaq-ut dhe zellin e gjithë këngëtorëve të tjerë-përveç dyve: Andrea Alilozi dhe Pandel Durmishi. Alilozi dhe Durmishi mirrin pjesë pa asnjë përjashtim në ushtërimet e korit, paraqiteshin dhe përpikësisht pas minutave që shënoheshin në orar, po që të dy vinin mbrëmnet si të lodhur nga tregëtimet e ditës dhe kishin dhe një zë fare të papërshtatur për kor; i pari me timbrin e trashë, me dridhje të panjështa, turbullonjëse; i dyti me korrdhëzat e fytyrës përherë të ngjyruara, përherë të gakovuara; njëri nxirte një farë toni si një violi me tela të gjerra, tjetri si një pllakë gramafoni të prishur: Na bënin disonancë në këngë, më thotë Asdreni, gjer sa i ndalonte profesori. Pol- gjer sa i ndalonte vetë mjeshtri Kiriaq: me qënë që, për qarjet e koristëve të tjerë, ata as që deshinin t'a dijnë kurrë: kishin gjetur kundër çdo ankimi një mprojtje stereotipike, dhe i-u përgjigjeshin shokëve me mëri: Pse? veç juve jini shqiptarë? Neve nuk jemi?! Dhe kori i tërë buçiste në gas...

Këta djem të mbledhenj të korit mbesonin dhe kishin bindje të plotë - se, për të vetëmen cilësi të të qenurit shqiptar edhe dyke mos pasur pajisjen sine qua non të një veshi muzikor - kishin të drejtë vetore të prishin vazhdimërisht harmoninë e një kori të tërë të një themelimi të vështirë dhe të pagmuarshëm, për hirin e të cilit Kollonija derthe të holla me duar plot, mbante me gjithë shpenzimet e ushqimit, të veshjes dhe të fjetjes priftin shqiptar, paguante veglat dhe notat dhe trikëmbëzhet muzikore, paguante sallën e koncerteve, shpërbente me shpërbllim të rëndë mjeshtrin më të famshëm të artit koral rumun, dhe priste qindëra mijë lei për rindregjen, për pajisjen dhe përmbajtjen e kishës kombëtare në Rumani.

Kështu ka qënë, dhe është, dhe do të jetë, fati dhe rrefimi dhe përballa, përgjithnjë dhe përgjithmonë, e atyreve që bëjnë punën e mirë të njerëzimit në botë, punën e mirë të atdheut për Shqipëri:

Sic resurgit gloria Albaniae...

**Pjesë nga studimi i Lasgush Podocit "Himi kombëtar Flamurit pranë të bashkuar" dhe gjezera e tij", marrë nga libri i sapobotuar "Korrespondencë Lasgush Poradeci Asdreni" Vepra V**

TRADITA | VLERA

# Faleminderit, atë Camodeca!

Pietro Abitante

**Pietro Camodeca de' Coronei preku Papa Leonin XIII, duke i kujtuar rapsoditë popullore që i këndonin Dukës së Borgonja-s kur mbërritën refugjatë nga Shqipëria si: "Petkat e të mira të tona/na i ljam te korona/Krishtin vet' kemi me ne/oj e bukura More/ thell të pljastë me ljet ndër sy/na të ljpisnjem,oj Arbëri"**

Mbrojtja dhe ruajtja e një minorance etniko-linguistike vjen sidomos nga afërsia e kufinjve me gjuhën "pritëse", siç është psh. italishtja për gjermanishten e altoatezinëve dhe për frengjishten e valdostanëve.

Por kur flitet për ishuj gjuhësorë, si ato shqiptare në Itali, nuk është e njëjta gjë. Roli kryesor në mbrojtjen e identitetit tonë e ka pasur feja: dihet që tradita dhe feja me ritualitetin e saj janë një binom historik i pa ndarë. Një shembull i qartë është figura e një prifti të shekullit XIX, Pietro Camodeca de' Coronei nga Castrolibero, qendër e vogël e Kalabrisë. Është falë edhe impenjimit të tij fetar dhe kulturor kundër padronëve dhe peshkopëve të zonës dhe thirrjeve të tija ndaj Kreut të krishterimit, Papa Leonit XIII, që sot mund të flasin për kulturën arbëreshe.

Kjo figurë e veçantë fetare, duke iu drejtuar Papës, bën thirrje së bashku me italo-sh-



## Faljeminderit, zoti Pietër Kamodhek!

Pietro Abitante

Petkat e të mira tona/na i ljam te korona/Krishtin vet' kemi me ne/oj e bukura More/ thell të pljastë me ljet ndër sy/na të ljpisnjem,oj Arbëri (I nostri beni li lasciamo a Corone, solo Cristo abbiamo con noi, o mia bella Morea, fondamentamente feriti con le lacrime agli occhi, noi ti invochiamo, o Albania)

Një minoranxë etniko-linguistike shumë herë ruhet kur është afër nacjunës që e fljet atë gjuhë ashtu si në "Taljet është për tedheskun në Alto Adige e për franxhizin në Valle d'Aosta. Po kur fljaset për aljbëreshët e tanë nek është ashtu: identiteti aljbëresh i duhet besës e rritit greco-bixantin: dihet se traditart e njeriut ectin gjithënjë me besën.

E kështu mirret vesh sa i rënd ka kljen roli i zotit Pietër Kamodheka

me gjithë zotrat e tij. Në 1860 u nxuar liturxhia, kenkat e të veshurat kljishje greke tipike. E riti u përzie me atë ljetirë.

Në këte mot ngrëhet figura e Kamodhekut për të ruajtjen e rritit grek. Në 27 llunarit 1887 i shkruan Papës, tue përgljunur për një eparki greke autonome ka veskovet ljetinj e për gjithë katundet aljbëreshë të Kalabrisë e të Bazilikatës e tue bërë riferimend buljës së Papës Leone X e 18 majit 1521, ku contemplarshin të drejtat e rritit grek afër aty latin. Zoti Pietër I fljet papës për gjindën aljbëreshë si njeriz poverjelj po kryeljartë për besën, pse klje për pjesë Skënderbeut ndë Maometi s'pat sit t'e mbaj fjalën "...të i a vëj turbantin mbi kryet e papës e henëzën mbi kljishës së Shën Pjetrit."

Në kljofitë ndrshye, shton i kljmuar arqipreti, "...vdes me rritin tënë, gljuha jonë e ljashte sa jeta, zakonët e tradhitat tona."

### Në 27 llunarit 1887 i shkruan Papës, tue përgljunur për një eparki greke autonome ka veskovet ljetinj e për gjithë katundet aljbëreshë

Ky popull u difëndir me një besë e fortë, ka akuzat ertike e ljetinjvet, tue kljultuar përljeshjat kundër arjanëvet, kundër veskovit I Tesalonikës, kundër Fazit e kundër Urosit. Kamodheku e ljeti ajutin të priftravet e vendit ka veskovi i Tursit-Anglonës së

Bazilikatës njera veskovet të kalabrisë e të shumëtën ishin dhakordu me atë, si duket me litrat të shumëta që shkruajtjn njeri tjetrit. Në 1918 papa Benedetto XV kriarti dy eparki me rritin grek, një për "Talien kontinentale në Ungër (Cosencë) e n'atër për Shqipërinë Pianën e aljbëreshëvet.

Veçëria relxhoze greke klje një support i madh për identitetin tënë i rallë kurse s'klje ashtu për katundet aljbëreshë që kljen katoligizuar, do me tënë se çdo petk i artës, i storjes e i kulturës i një populli vete gjithënjë me rritet e besës.

Një faljenderim i madh zotit Pietër Kamodhek, një prift i uljet e i paljodhur që tue difënditurin rritin grek, na difëndituri menjëherë kljuhën e tradhitat e tona.

**Përkthimi nga: Pietro Abitante**

### Më 27 korrik 1887 i drejtohet Papës, me letrat e tij, duke u lutur për një dioqezë autonome nga peshkopët latinë për fshatrat arbëreshë

qiptarët e tjerë të kohës, për krijimin e një dioqeze autonome me ritual greko-bizantin, duke mbrojtur njëkohësisht historinë dhe vazhdimësinë e kulturës së komuniteteve tona. "...luftuam për fenë e Krishtit nën të Madhin (Skënderbe) që u emërua gjeneral i Lidhjes së Shenjtë... ramë si trima pas 23 betejash dhe ndërsa turku shpërthehte mbi humbësit... Papa i kohës na priti mirësisht në mbretërinë e Napolit" dhe e preku duke i kujtuar rapsoditë popullore që i drejtuan Dukës së Borgogna-s kur mbërritën refugjatë nga Shqipëria si:

"Petkat e të mira tona/na i ljam te korona/Krishtin vet' kemi me ne/oj e bukura More/ thell të pljastë me ljet ndër sy/na të ljpisnjem, moj Arbëri

Në fakt, u ishin marrë privilegjet dhe ekskluzivitetet e fituara me mbërritjen e tyre në shekullin XVI: me kohën këto lehtësira u zbehën dhe padronët e peshkopët e zonës, duke mos duruar këtë dualizëm fetar, latinizuan një pjesë të mirë të fshatrave albanofone të rritit grek. Pati një tentativë të

lavdërueshme të Felice Emanuele Rodotà me themelimin, me shpenzimet e tij, të një Kolegji italo-grek në San Bededetto Ullano që u zhduk me persekutimin e peshkopit dhe priftërinyje të tij. Në 1860 u ndalua liturgia greke, kënga korale dhe veshitja tipike. Kis hat u bënë hibride në ritualitetin e tyre.

Në këtë periudhë figura e Camodeca-s ka një rol historik në mbrojtjen dhe rifitim e rritit grek. Në 27 korrik 1887 i drejtohet Papës, me letrat e tij, duke u lutur për një dioqezë autonome nga peshkopët latinë për fshatrat arbëreshë të Kalabrisë dhe Bazilikatës, duke iu referuar precedentit të Leonit X që më 18 maj 1521 krijoi juridikisht peshkopin e rritit grek përkrah atij të rritit latin. Pietro Camodeca në thirrjen e tij flet për popullin e tij të varfër por krenar për fenë e vet, pasi falë Skënderbeut dhe njerëzve të tij Muhamedi nuk mundi të realizonte projektin për t'i "...vënë çallmën në kokë Papës dhe hënën në kupolën e Shën Pjetrit".

Përndryshe, shton me trish-

tim prifti: "...do të vdesin me ne rituali ynë, gjuha jonë antike sa bota, zakonet tona, traditart tona".

Ky popull ishte mbrojtur falë besimit të tij ekzemplar nga akuzat për herezi, duke cituar betejet kundër arianëve, kundër peshkopit të Selanikut, kundër herezive të Fozio dhe Urosio-s. Kërkon solidaritetin e peshkopëve të zonës, nga Bazilikata në Calabri, që kryesisht ishin dakort, nga sa mësohet nga korrespondenca e epokës. Në vitin 1918 u krijuan nga Papa Benedikti XV dy dioqeza të rritit grek, një për Italinë kontinentale me seli në Lungro, në provincë të Kozencës dhe një tjetër për Sicilinë në Piana degli Albanesi. Dallimi fetar ishtë një mbështetje esenciale për mbrojtjen e këtij identiteti të jashtëzakonshëm, gjë që nuk noddhi me komunitetet albanofone të katolizuara.

Faleminderit Pietro Camodeca de' Coronei-t, një figurë fetare e thjeshtë dhe e palodhur që duke mbrojtur rikthimin e ritualitetit fetar mbrojtji, njëkohësisht, pasurinë tonë historike, artistike dhe kulturore!

ARKIVAT | AMERIKANE

Agron Alibali

Pjesa II

Sot pranohet përgjithësisht se hebrejtë që u zhvendosën në Shqipëri gjatë Luftës II Botërore janë shpëtuar që të gjithë, ndërsa në Kosovë disa prej tyre nuk e patën këtë fat. Edhe propaganda e qarqeve serbe nuk ka munguar të nxijë realitetin historik që lidhet me këto ngjarje.

Mirëpo në këtë drejtim ka një neglizhim të paspjegueshëm edhe tek të tjerët. Kështu, edhe libri i shumëpërmendur "Besa" me foto të shqiptarëve që kanë shpëtuar hebrejtë gjatë Luftës, me autor Norman Gershman, një pjesë të mirë të personazheve të tij i ka nga Kosova, por kjo pak theksohet në përmbajtje apo në ekspozimet e shumta nëpër botë të këtyre fotove të rëndësishme.

Dokumenti amerikan i përcjellë edhe në Pjesën II zbulon një përmasë të re të kontributit të popullit të Kosovës në shpëtimin e hebrejve të ish-Jugosllavisë që u detyruan të gjejnë strehim atje.

Letrat e Identitetit

Sikurse u përmend në Pjesën I, Letra e Identitetit ishte një prej dokumenteve të lëshuara në Shqipëri dhe të përdorura nga hebrejtë për të fshehur identitetin e tyre të vërtetë dhe për t'i shpëtuar kësajsoj vales naziste.


Raporti ynë përmend se Letra e Identitetit përdorej edhe nga hebrejtë në Kosovë. Kështu, aty thuhet se njëfarë "Saltihel Beraha e siguroi Letrën e Identitetit nëpërmjet xhaxhait të tij në Prishtinë, njëfarë L. Jacov M. Cohen, i cili shpërbleu për këtë shërbim një nëpunës në fshatin e vogël të CIKATOVO-s", një fshat në komunën e Drenasit. Si në rastet e tjera, vullat dhe nënshkrimi i dokumentit ishin të sakta, kurse natyrisht që emri ishte i rremë.

Kontrollet rrugore në Shqipëri

Dokumenti përmend edhe kontrollet rrugore në Shqipëri, duke theksuar se "gjermanët nuk kishin sistem kontrolli rrugor, përveç rojave në urat midis Tiranës dhe Shkodrës." "I gjithë kontrolli rrugor - nënvizonte dokumenti - kryhej nga kosovarët, por përgjithësisht ata e kishin mëndjen tek kontrabanda". Ky pohim i rëndësishëm le të kuptojë se kontrollet rrugore të xhandarëve ishin në përgjithësisht poroze.

Dëshmitë e Pagëzimit

Kështu, në sythin Testimonium Baptismi ose "Dëshmi pagëzimi", raporti i zbuluar në arkivat amerikane përmend se prifti katolik i kishës së Ferizajt, emri i të cilit jepet si Joseph Radoha, u kishte lëshuar dokumente pagëzimi "shumë personave për t'i ndihmuar që të merrnin dokumente të tjera". Burimi për këtë informatë



Në foto: (Lart) Faksimile e dokumentit, ku përshkruhet aktiviteti i priftit katolik Jozef Radoha dhe popullit të Ferizajt. (Djathtas) Facsimile e dokumentit ku përshkruhen ndryshimet dokumentare të kryera nga zyra e avokat Zozitit në Tiranë.

# STREHIMI I HEBREJVE

## Falsifikimi i dokumenteve shtetërore dhe fetare në Kosovë

Etërit katolikë në Shkup dhe Ferizaj ishin kthyer në mbrojtës të devotshëm të refugjatëve të huaj - kryesisht hebrej. Madje ata punonin në mënyrë sistematike, si njëfarë rrjeti i sofistikuar, duke ofruar strehim, dokumente pagëzimi dhe transport bagazhi...

ishte njëfarë Masha Varon Marcus, i cili vetë kishte përfutur dëshmi pagëzimi prej priftit të Ferizajt. Si i vetmi prift katolik atje, At Radoha kishte strehuar në kishë, dhe në shtëpinë e tij "shumë refugjatë, përfshirë jugosllavë, hebrej, grekë, etj".

At Radoha ishte - sipas raportit - në lidhje të ngushtë me priftin katolik të Shkupit, i cili, nga ana e vet, ishte kanali kryesor për dërgimin e bagazheve të refugjatëve nga Jugosllavia për në Shqipëri.

Për priftin Radoha dihet fare pak. Ai ishte me prejardhje diku nga Evropa Qendrore dhe ishte caktuar të shërbente në Ferizaj. Po ashtu, sipas një burimi italian, At Jozef Radoha, ishte prift salesian dhe fliste mirë edhe italisht, pasi kishte studiuar në kongregacionin e Valdoccos, pranë Torinos, në Itali. Po sipas të njëjtit burim, rreth viteve 1942-1943, kur Kosova ishte nën administrim italian, At Radoha u gjend në rrezik për t'u denoncuar si "spion rus" dhe u shpëtua nga njëfarë Sarcheletti. [Burimi: Luigi Sarcheletti - ADMA Verona].

Kurse Peshkop në Shkup në atë kohë ishte Smiljan Franjo Ceka, i cili më pas u bë anëtar i Concileve të II të Vatikanit dhe Arqipeshkv i Sarajevës. Në Peshko-



Foto që tregon momentin e lumtur të largimit nga Tirana në shtator 1945 të hebrejve të shpëtuar gjatë Luftës II Botërore. Transportimi i tyre përfundimtar krye me ndihmën e UNRRA-s. Mirënjohje për botim arkivës UNRRA.

patën e Shkupit, është rasti për t'u përmendur se deri në vitin 1921 ishte si Peshkop Lazër Mjeda, i cili më pas u emërua Arqipeshkv i

Shkodrës. Nga raporti kuptohet qartë se etërit katolikë në Shkup dhe Ferizaj ishin kthyer në mbrojtës të

devotshëm të refugjatëve të huaj - kryesisht hebrej - që përpleshin t'i shpëtonin terrorit dhe përndjekjeve nazi-fashiste. Madje ata punonin në mënyrë sistematike, si njëfarë rrjeti i sofistikuar, duke ofruar strehim, dokumente pagëzimi dhe transport bagazhi.

Disa përfundime paraprake mund të nxirren edhe sot e gjithë ditën:

Së pari, angazhimi i prelateve katolikë në Kosovë dhe Maqedoni për shpëtimin e hebrejve bie ndesh me politikën e atëherëshme të ndjekur nga Papa Piu XII, e cila është e diskutueshme edhe sot e gjithë ditën.

Së dyti, kjo veprimtari kaq e gjerë dhe e dendur nuk mund të mos bëhej pa dijeninë, dhe për më tepër, pa mbështetjen e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të shqiptarëve të Ferizajt me rrethe, si dhe popullsisë shqiptare e maqedonase të Shkupit. Këtu doemos përfshihet jo vetëm popullsia civile, por edhe administratë vendase.

Kjo faqe e panjohur e historisë së Kosovës, e cila pret të hulumtohet më tej, vërteton se, sikurse në Shqipëri, edhe në Kosovë strukturat shtetërore, shoqërore dhe fetare u angazhuan tërësisht për shpëtimin hebrejve të Kosovës dhe të viseve të tjera të ish-Jugosllavisë.